



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*  
*Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju*  
*Ministry of Education Science & Technology*

*Kabineti i Ministrët / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister*

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, dt.21 tetor 2010), nenet 48, 49 paragrafit 1 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar (Gazeta Zyrtare nr. 17, dt. 16. shtator 2011), Ligjit për Mërgatën e Kosovës nr. 03/L-171, si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt. 22.03.2011), nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Për shkollat e mësimit plotësues në gjuhën amtare në diasporë**

**Numër:** 10.2011

**Datë:** 30.12.2011

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky udhëzim administrativ përcakton qëllimin, mënyrën, kriteret, kushtet dhe mjetet e organizimit të mësimit plotësues në gjuhën amtare në diasporë (në tekstin e mëtejme vetëm MP) si dhe të drejtat dhe detyrat e MASHT të Kosovës lidhur me të (MP).

## **Neni 2**

### **Shërbimi në MASHT të Kosovës dhe fushat e mbështetjes**

1. MASHT e Kosovës ka themeluar shërbimin/sektorin e posaçëm për koordinimin dhe mbështetjen e organizimit të MP në diasporë.
2. Sektori për MP në diasporë, përmes shfrytëzimit të të gjitha kapaciteteve humane e materiale në MASHT dhe të koordinimit ndërsektorial të tyre, ofron mbështetjen profesionale, organizative dhe materiale për MP në diasporë.
3. Sektori për MP në diasporë ndërton konceptin e krijimit dhe të administrimit të të dhënave (banka e të dhënave) dhe funksionalizimin e shkollës mbi bazën e këtyre (të dhënave) dhe të faktorëve të tjerë.
4. Sektori për MP në diasporë lidhet dhe zbaton politikat e MASHT të Kosovës dhe ato qeveritare, prej atyre ndërministrore brenda Qeverisë së Kosovës e deri te ato ndërqeveritare-ndërministrore ndërmjet MASHT të Kosovës dhe të shteteve tjera fqinje të interesit të përbashkët në këtë fushë.

## **Neni 3**

### **Qëllimet themelore të shkollës së MP në diasporë**

1. SHMP në diasporë mbështet krijimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor e shtetëror të fëmijëve dhe të rinjve të Kosovës përmes zhvillimit e thellimit të kompetencave për gjuhën dhe letërsinë kombëtare, gjeografinë e historinë kombëtare, kulturën muzikore dhe kulturën figurative kombëtare si dhe të fushave të tjera identike.
2. SHMP në diasporë mbështet zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejme dhe të vazhdueshëm të këtij identiteti.
3. SHMP në diasporë mbështet krijimin e bazës së mjaftueshme kulturore dhe arsimore për integrim më të lehtë dhe të natyrshëm në shoqërinë vendore (të vendit pritës) dhe zhvillimin e balancuar të kompetencës ndërkulturore.
4. SHMP në diasporë mbështet riintegrimin apo integrimin sa më të lehtë dhe të natyrshëm në sistemin e arsimit në atdhe apo në përgjithësi në shoqëri, në rast të kthimit.

## **Neni 4**

### **Financimi dhe baza materiale e shkollës së MP**

1. Sipas dispozitave përkatëse të institucioneve të Republikës së Kosovës (Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Ligji nr. 04/L-032) dhe të Ligjit për Mërgatën e Kosovës 03/L-171) ndërtohen edhe politika dinamike për mbështetjen buxhetore/financimin e MP në diasporë.
2. Në disa shtete, respektivisht në disa njësi federale të këtyre shteteve financimi i rregullt i shkollës së MP bëhet nga fondet e rregullta të këtyre shteteve, natyrisht sipas dispozitave përkatëse për shkollën e MP në gjuhën amtare (shkolla për gjuhën dhe kulturën e origjinës) apo të politikave integruese dhe ndërkulturore, ndërkaq në disa shtete tjera, apo njësi federale të veçanta shtetesh, financimi bëhet mbi bazën e

- kontributit material të bashkatdhetarëve në kuadër të vetorganizimit të tyre shoqëror e kulturor në shoqata, klube, këshilla prindërishe e arsimtarësh për shkollën etj.
3. MASHT e Kosovës do të bëjë financimin e programeve të veçanta të hartimit të kurrikulave, të teksteve e të mjeteve të duhura mësimore, të komunikimit e të bashkëpunimit me subjekte të veçantë në Kosovë dhe jashtë saj, të organizimit të mbështetjes e të mbikëqyrjes profesionale, të organizimit të tribunave, konferencave, seminareve, garave e takimeve të veçanta, të vizitave të ndryshme të ndërsjella, të ekskursioneve mësimore, të pajisjes së vazhdueshme të bibliotekës, mediatekës etj.

## **Neni 5**

### **Organizimi i MP dhe kushtet**

1. MASHT e Kosovës, në përputhje me dispozitat përkatëse të Republikës së Kosovës dhe në përputhje me dispozitat e shteteve e marrëveshjet dypalëshe me shtetet përkatëse dhe me konventat tjera ndërkombëtare, gjithnjë sipas kurrikulës së veçantë që e miraton, mbështet organizimin e mësimit plotësues në gjuhën amtare në diasporë, duke bërë njëkohësisht koordinimin e veprimeve ndërmjet subjekteve të ndryshme profesionale dhe të tjerë mbështetës brenda dhe jashtë Kosovës.
2. Sipas interesave arsimore-kulturore të nxënësve/eve dhe të identitetit të tyre kombëtar/kulturor, MASHT e Kosovës bashkëpunon me institucionet homologe dhe të tjera shtetërore të shteteve fqinje duke hartuar politika e protokolle të bashkëpunimit, kurrikula të përbashkëta, tekste e mjete tjera didaktike etj.
3. MASHT e Kosovës, në përputhje me kapacitetet buxhetore, sipas dispozitave përkatëse të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe me shtetet përkatëse, bën edhe përzgjedhjen e kuadrit profesional dhe participon në financimin e tij, duke përcaktuar me akt të veçantë nënligjor edhe kushtet dhe procedurat e përzgjedhjes së tij.
4. MP në diasporë mund të organizohet në ato mjedise (qytete, regjione) ku ka numër të mjaftueshëm të nxënësve/eve dhe kuadër të duhur profesional.
5. Grupi mësimor është njësi themelore e organizimit të mësimit dhe zakonisht përbëhet prej 15 nxënësve/eve të moshave/klasave zakonisht të ndryshme (paralelet e bashkuara-të kombinuara) apo të njëjta, ku, edhe sipas kompetencave paraprake, grupi mund të ndahet në nëngrupe.
6. Një shkollë e MP duhet të ketë së paku 50 nxënës.
7. Në rast se sigurohet burimi financiar, ose në rast se dispozitatat e vendit mikpritës e parashikojnë, shkolla mund të themelohet edhe me numër më të vogël nxënësish/esh.
8. Rëndom numri i nxënësve/eve për grupet dhe shkollat përcaktohet me dispozitat ligjore të autoriteteve vendore të arsimit apo të shërbimeve tjera vendore që merren me çështjen e të drejtave dhe të mirëqenies së qytetarëve të origjinës tjetër (të huaj) apo me status jorezidentë.

**Neni 6**  
**Kohëzgjatja e vitit shkollor, kalendari shkollor**

Shkolla e MP në gjuhën amtare punon sipas kalendarit shkollor të vendit mikpritës.

**Neni 7**  
**Vijuesit (frekuentuesit) e shkollës së MP në diasporë**

1. Shkollën e MP e ndjekin fëmijët apo të rinjtë e moshës së nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm (6-18 vjeç) në përputhje me veçantitë e sistemeve shkollore të shteteve mikpritëse, të cilët së bashku me familjet e tyre jetojnë në ato shtete, pavarësisht se çfarë është statusi i tyre (shtetas të shtetit përkatës, qytetarë a punëtorë me qëndrim të përkohshëm, të strehuar të përkohshëm, azilkërkues ekonomikë etj.).
2. Këtë shkollë mund ta ndjekin edhe njerëz të tjerë vendorë të origjinës tjetër, të cilët për motive të ndryshme shprehin interesim për Kosovën si identitet e entitet (në të gjitha planet).

**Neni 8**  
**Sa zgjat shkolla e MP në gjuhën amtare**

1. Në shtetet apo në disa njësi federale shtetesh ku MP konsiderohet si obligim i autoriteteve vendore të arsimit, respektivisht është integruar në sistemin vendor, shkolla e MP në gjuhën amtare zgjat aq sa është e rregulluar me dispozitat përkatëse të atyre shteteve (zakonisht 10-12 vjet).
2. Në rastet tjera shkolla e MP zgjat 12 vjet.
3. Sipas kohës mësimi është ndarë në katër nivele-cikle:
  - 3.1. **niveli i parë** përfshin klasat I-III,
  - 3.2. **niveli i dytë** përfshin klasat IV-VI,
  - 3.3. **niveli i tretë** përfshin klasat VII- IX,
  - 3.4. **niveli i katërt** përfshin klasat X-XII.

**Neni 9**  
**Kohëzgjatja e mësimi**

1. Mësimi i rregullt (orët e rregullta të MP) mbahet 1 herë në javë me tri orë mësimi.
2. Ora mësimore zgjat aq sa zgjat një orë mësimore me dispozitat e vendit mikpritës, respektivisht më së paku 45 minuta (si në Kosovë).
3. Mësuesit janë të obliguar që në kuadër edhe të 3 orëve të tjera shtesë, sipas afiniteteve dhe interesimeve të fëmijëve, të zhvillojnë veprimtari-aktivitete të ndryshme jashtëmësimore (kulturore-sportive etj.), të cilat zakonisht, nëse nuk ka mundësi të zhvillohen në lokalet normale të shkollave, zhvillohen gjatë ditëve të vikendit, nëpër hapësirat-lokalet e shoqatave, klubeve, qendrave kulturore etj.

## **Neni 10** **Kurrikula**

1. Mësimi plotësues zhvillohet me kurrikul të veçantë të hartuar dhe miratuar prej MASHT të Kosovës, e cila përfshin gjuhën dhe letërsinë shqipe, historinë e gjeografinë kombëtare, kulturën muzikore dhe figurative kombëtare si dhe fushat tjera të kulturës kombëtare në përgjithësi.
2. Për të qenë sa më e përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse si dhe sa më e përputhshme me vullnetin dhe politikat integruese të popullit të Kosovës ajo (kurrikula) bashkëhartohet apo harmonizohet edhe me subjektet dhe dokumentet e ngjashme të shteteve fqinje, sipas interesave të përbashkëta.
3. Në hartimin e kurrikulës gjithnjë konsultohet dhe kërkohet edhe përvoja e ndihma e mësuesve/eve që aktualisht punojnë në MP në diasporë.
4. Kurrikula hartohet për katër nivele-grupe moshash-klasash :
  - 4.1. niveli i parë për klasat I-III,
  - 4.2. niveli i dytë për klasat IV-VI,
  - 4.3. niveli i tretë për klasat VII-IX,
  - 4.4. niveli i katërt për klasat X-XII.

## **Neni 11** **Tekstet dhe mjetet tjera mësimore**

1. MASHT të Kosovës, sipas ligjit dhe standardeve përkatëse, udhëheq hartimin e teksteve dhe të mjeteve të përshtatshme mësimore për MP në diasporë, apo ndërmerr veprime të përbashkëta të interesit të ndërsjellë me shtete të tjera fqinje, duke gjetur modelin më të mirë të kyçjes së ekspertëve përkatës nga vendi dhe diaspora.
2. Tekstet dhe mjetet tjera mësimore për nxënës dhe mësues po ashtu hartohen a përgatiten për katër nivelet e grup- moshave klasave.
3. Në hartimin e teksteve gjithashtu do të konsultohet dija dhe përvoja e mësuesve që direkt punojnë në mësim në diasporë.
4. Tekstet e integruara mësimore po ashtu duhet të shoqërohen me tekstet-doracakët a fletoret tjera/të punës/tjerë të duhur shpjegues për nxënës dhe mësues.
5. Në kuadër të informatizimit të MP në diasporë, brenda web-faqes zyrtare, nën njëpërkujdesje profesionale (mësimi hipermedial, mësimi në distancë, mësimi elektronik apo E-learning), MASHT e Kosovës duhet të ndërtojë portalin e veçantë mësimor dinamik (në INTERNET).

## **Neni 12** **Mësuesit/et (kuadri)**

1. Mësuesit/et e shkollës së MP duhet të kenë kualifikim për mësimdhënie, së pakut, të nivelit të fakultetit dhe zakonisht të shkencave-degëve që kanë të bëjnë më shumë me lëndët e gjuhës dhe grupit të lëndëve të kulturës kombëtare.
2. Pranimi- zgjedhja e mësuesve/eve bëhet përmes konkursit publik.
3. Në lokalitetet ku shkolla e MP nuk financohet nga autoritetet arsimore vendore, por nga burimet alternative të prindërve a shoqatave të bashkatdhetarëve, pranimin-

zgjedhjen e kuadrit e bën komisioni në përbërje të zyrtarit profesional të MASHT të Kosovës dhe përfaqësuesve të fondacionit a shoqatës përkatëse (zakonisht të këshillit të shkollës dhe mësuesve të shtetit a regjionit përkatës vendor) të bashkatdhetarëve .

4. Në shtetet, a njësitë federale të shteteve, ku MP është kompetencë e plotë e tyre dhe e rregulluar me dispozita të veçanta regjionale a federale, MASHT do të kërkojë që të ketë të drejtën, nëse jo të zgjedhjes së kuadrit, së paku të dhënies së miratimit dhe të ekspertizës/vlerësimit profesional për kuadrit.
5. Mësuesi pranohet në punë me kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi të paafatizuar, respektivisht deri në pension apo në bazë të dispozitave përkatëse të institucioneve përkatëse.
6. Lidhur edhe me shumë detaje të tjera, MASHT e Kosovës do të përgatisë rregullore të veçantë për kushtet dhe kriteret e zgjedhjes së kuadrit për MP në diasporë si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

### **Neni 13**

#### **Aftësimi profesional i kuadrit**

1. MASHT e Kosovës kujdeset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve/eve të MP.
2. Për kryerjen me sukses të aftësimit profesional, sipas dispozitave e programeve përkatëse, mësuesit/et pajisen me certifikatë përkatëse.
3. Në funksion të aftësimit profesional, sipas një koncepti e programi special, MASHT e Kosovës, në bashkëpunim me institucione e subjekte tjera, organizon seminarin e rregullt vjetor disa ditësh në Kosovë (në fund të vitit mësimor) ose seminare tjera mbështetëse jashtë atdheut sipas kushteve dhe interesave të caktuara.
4. Seminari i rregullt vjetor mund të bashkorganizohet, sipas interesave të ndërsjella të përbashkëta, edhe me shtete tjera fqinje dhe është lëvizës.

### **Neni 14**

#### **Bashkëpunimi me prindërit dhe këshilli i shkollës**

1. Prindërit dhe mësuesit bashkëpunojnë ndërmjet tyre në kuadër të të gjitha formave të njohura të bashkëpunimit (mbledhjeve, kontakteve, vizitave, komunikimit elektronik etj.) dhe posaçërisht në kuadër të këshillit të shkollës-prindërve, i cili zakonisht përbëhet nga mësuesit/et dhe prindërit e deleguar sipas grupeve të nxënësve.
2. Këshilli i shkollës ndihmon punën e shkollës, por nuk ka kompetenca të ndërhyrjes profesionale.
3. Kryetari dhe arkëtari i këshillit të shkollës zgjidhen nga radhët e prindërve me mandat njëvjeçar me mundësi rizgjedhjeje, ndërsa punët e sekretarit teknik zakonisht i kryen mësuesi.
4. Në qytetet ku punon vetëm një mësues/e, këshilli i shkollës së MP përbëhet nga 2 prindër të deleguar prej çdo grupi mësimor, ndërsa në qytetet ku punojnë dy e më tepër mësues në të (këshillin e shkollës) delegohen nga një prind prej çdo grupi mësimor duke formuar, në këtë mënyrë, këshillin qendror të shkollës në nivel të qytetit. Varësisht nga modeli i organizimit juridik-administrativ të shtetit përkatës,

- mund të formohen këshilla të shkollës edhe në nivel kantonal, regional, të rrethit, regjionit e deri në nivel qendror të shtetit.
5. MASHT e Kosovës do të përgatisë një udhëzim të veçantë për modalitetet më të mira të bashkëpunimit me prindër.

#### **Neni 15**

#### **Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe shkollën vendore**

1. Shkolla e MP bashkëpunon me të gjitha institucionet vendore të cilat merren me çështjet e të huajve, posaçërisht me autoritetet dhe institucionet arsimore.
2. Në mënyrë të veçantë mësuesit/et e MP bashkëpunojnë me autoritetet zyrtare (drejtorin) dhe organet profesionale (me mësuesit vendorë të shkollave) vendore ku organizohet MP.

#### **Neni 16**

#### **Dokumentacioni pedagogjik**

1. Për shkollën e MP, nga MASHT e Kosovës, përgatitet dokumentacion i veçantë pedagogjik, i cili, në raste të veçanta, mund të jetë i njëjtë apo duhet të harmonizohet edhe me dokumentacione të ngjashme të shteteve fqinje.
2. Dokumentacionin pedagogjik e përbëjnë:
  - 2.1. Libri amë i shkollës,
  - 2.2. Libri i klasës,
  - 2.3. Certifikata për kryerjen e klasës, respektivisht shkollës,
  - 2.4. Libreza e nxënësit.
3. Certifikatën e nënshkruan mësuesi/sja i/e shkollës së MP dhe personi i autorizuar i shkollës së vendit mikpritës.
4. Certifikata vërtetohet me vulën e institucionit përkatës vendor, të shoqatës a të themelatës/bartësit të organizimit të MP, të përfaqësisë konsullore të Kosovës etj.
5. Në raste të veçanta, për nevoja të përdorimit në Kosovë, certifikata mund të nostrifikohet nga zyrtari i autorizuar në MASHT të Kosovës.
6. Certifikata duhet të jetë në gjuhën amtare të nxënësit/es dhe në gjuhën zyrtare të shtetit ku zhvillohet MP.

#### **Neni 17**

#### **Komunikimi dhe bashkëpunimi profesional si dhe themelatat profesionale të mësuesve**

1. Mësuesit duhet të komunikojnë vazhdimisht me MASHT të Kosovës, respektivisht me njësinë-shërbimin profesional të kësaj ministrie për MP në diasporë.
2. MASHT e Kosovës organizon takime pune me mësuesit/et e MP në diasporë, së paku një herë në vit, nënkuptohet gjatë pushimeve dhe pas konsultimit paraprak me ta për terminet dhe vendtakimet më të përshtatshme.

3. MASHT e Kosovës mbështet formimin e këshillave profesionale të mësuesve/eve në kuadër të shteteve, njësisive të veçanta federale të shteteve ose qyteteve të mëdha me shumë mësues/e dhe të këshillave qendrore të mësuesve/eve në nivel të grup-shteteve, në aspekt hapësinor më kompakte, dhe të diasporës në Evropë.
4. MASHT shqyrton mundësinë e mbështetjes materiale sipas kërkesave të këshillave e shoqatave profesionale të mësuesve/eve për realizimin e projekteve konkrete për avancimin e mësimit plotësues në diasporë.
5. MASHT e Kosovës do të përgatisë një udhëzim të posaçëm për modalitetet dhe format e bashkëpunimit dhe interkomunikimit profesional të mësuesve/eve të MP në diasporë.

### **Neni 18**

#### **Rregullat dhe rendi shtëpiak në shkollë**

1. Nxënësit/et, mësuesit/et dhe prindërit duhet të sillen në përputhje me rregullat e shkollës, në të cilën zhvillohet mësimi.
2. Edhe masat ndaj nxënësve/eve, mësuesve/eve dhe prindërve merren sipas rregulloreve të shkollës vendore.
3. Një rregullore e përgatitur nga MASHT e Kosovës do të përcaktojë më tej masat e duhura sipas situatave të veçanta.

### **Neni 19**

#### **Vlerësimi i kompetencave**

1. Vlerësimi i kompetencave të nxënësve/eve bëhet në formë përshkrimi sipas tri shkallëve:
  - 1.1. nuk ka kënaqur,
  - 1.2. i /e/ suksesshëm/me,
  - 1.3. i /e/ shkëlqyeshëm/me.
2. Valid është edhe vlerësimi i cili bëhet sipas kriterëve të shkollës vendore.

### **Neni 20**

#### **Mbikëqyrja profesionale**

1. Përgjithësisht mbikëqyrjen profesionale, sipas dispozitave përkatëse, e bëjnë autoritetet profesionale dhe zyrtare të vendit ku punon shkolla.
2. Në vendet e rastet ku bartës i organizimit është institucioni i Kosovës dhe në raste e situata të tjera të caktuara, që i referohen bartësit vendor joqeveritar, mbikëqyrjen e bën MASHT e Kosovës.
3. Një mbikëqyrje të veçantë mund ta bëjnë edhe autoritetet e shkollës vendore ku mbahet mësimi dhe autoritetet tjera profesionale, po ashtu, të vendit ku punon shkolla.




**Neni 21**  
**Dispozita shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet udhëzimi administrativ nr.10/2005 dt. 04.03.2005 .

**Neni 22**  
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Ministri.

  
**Prof. Dr. Ramë Buja, ministër**

